



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2019:225564

Datë: 11.12.2019

Numri i dokumentit: 00705947

DKR.P.nr.03/2019

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE- Departamenti për krime të Rënda në Pejë, Kryetari i trupit gjykues – Gjyqtari, Sylë Lokaj, antaret e trupit gjykues –Gjyqtaret Sejdi Blakaj dhe Ahmet Regaj e me pjesëmarrjen e sekretares juridike Binake Mulliqi, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore – Departamenti për Krime të Rënda në Pejë, PP.I nr.125/17 dt.18.01.2019 të ndryshuar me dt. 18.03.2019 dhe në shqyrtimin kryesorë dt.09.10.2019, kundër të akuzuarit D.Gj. , për vepër penale, blerja posedimi shpërndarja, shitja e pa autorizuar i narkotikeve , substancave psiko-tropike dhe analoge nga neni 273 par.1 të KPK-së dhe kundër të akuzuarve B.A dhe E. A , si bashkë kryes për shkak të veprës penale, blerja posedimi shpërndarja, shitja e pa autorizuar i narkotikeve , substancave psiko-tropike dhe analoge nga neni 273 par.2 lidhur me nenin 31 të KPK-së. pas mbajtjes së shqyrtimit kryesorë, verbale e publik, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Sahide Gashi, të akuzuarit D.Gj. dhe mbrojtësit Av. Flamur Kelmendi, të akuzuarit B.A , mbrojtësit Av. Filloreta Hogja, të akuzuarit E.A, mbrojtësit Av. Rrustem Lajqi të gjithë nga Peja, me **09.10.2019** mur dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

1. D. Gj. i biri i M. dhe L. e gjinisë L. lindur me ... në Pejë me banim në rr.”... në Pejë, Student ,i pa martuar ,i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës se Kosovës , i pa gjykuar me parë, ka qnë në arrest shtëpiak nga dt. 26.10.2017 deri me dt.28.12.2017 tani ndodhet në liri.
2. B.A i biri i S. dher H. e gjinisë Z. i lindur me ... në Deqan , me banim në ... në Pejë ID ..., ka të kryer shkollën e mesme i pa martuar ,i gjendjes së mesme ekonomike Shqiptar shtetas i Republikës se Kosovës , i gjykuar me parë, ka qenë në paraburgim nga dt.11.08.2018 deri me dt. 10.09.2018, tani ndodhet në liri.
3. E. A. i biri i S. dher H. e gjinisë Z. i lindur me ... në Deqan , me banim në ... Pejë ID ... ka të kryer shkollën e mesme i pa martuar ,i gjendjes së mesme ekonomike Shqiptar shtetas i Republikës se Kosovës , i pa gjykuar me parë, tani ndodhet në liri.

JANË FAJTOR

1. **I akuzuari: D.Gj.**

- **Për shkak se :**

Në kohë të pa caktuar e deri me dt. 26.10.2017 rrethe ora 8.30 në Pejë , ne vazhdimësi pa autorizim ka shite substanca te shpallur me ligje si narkotike , ne atë mënyrë qe pasi qe paraprakisht kishte siguruar narkotikun nga te pandehurit E. dhe B. A. dhe po e bënte gati për shitje , me rastin e kontrollit dhe bastisjes në shtëpinë e ti nga njësia e hetimeve për trafikim me narkotik ne Pejë, këta ja gjejnë dhe sekuestrojnë sasinë prej 311,9 gram si dhe ne shportën e mbeturinave kanë gjetur 4 cigare me mbetje te maurianes , janë sekuestrua 25 qese te vogla plasmasi te gatshme për mbushje me narkotik dhe 1 mulli për bluarjen e mahurianes.

-me çka ka krye vepër penale, blerja posedimi shpërndarja, shitja e pa autorizuar i narkotikeve , substancave psiko-tropike dhe analoge nga neni 273 par.1 të KPK-së

2.Te akuzuarit B. A. dhe E. A.

Për shkak se :

Ne kohen e pa caktuar e gjere me dt.11.,08.2018 , rrethe orës 18, 55 , ne Rr. p. N ne Peje , ne vazhdimësi , e me marrëveshje njeri me tjetrin pa autorizim, për mes te pandehurve D.Gj. , L. F. dhe S. ZH , kane shitur substanca te shpallura me ligje si narkotik te llojeve te ndryshme si : Kokain, hashash , mahurian , ne atë mënyrë qe gjatë kontrollit në shtëpinë e tyre, njësitit i antidrogës ka gjet dhe sekuestrua ne katin përdhese 7 qese te paketuuar me narkotik te llojit kokaina ne peshe prej 3.2 gram , ne një kuti metalike ne atelen e te pandehurit B. është gjetur një qese me narkotik te llojit kokainë me pesh prej 5 gram , ne aktin e dytë te shtëpisë ne një komode ne pakon e cigareve është gjetur substanca narkotike e llojit marihuan , ne peshe prej 2.1 gram , si dhe 0.3 gram hashash , 1 peshore digjitale për matjen e narkotikut dhe një kulet ne te cilën ishin 1.050,00 euro, te fituar nga shitja e narkotikeve e te cilat janë sekuestrua.

-me çka si bashkëkryes kanë krye vepër penale, blerja posedimi shpërndarja, shitja e pa autorizuar i narkotikeve , substancave psiko-tropike dhe analoge nga neni 273 par.2, lidhur me nenin 31 të KPK-së

Andaj Gjykata me aplikimin e neneve 4, 7, 17 par.1, 21 par.2, 41, 46, 62 par.2 pika 2.7, 69, 73, neni 273 par.1 dhe 2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së , e lidhur me nenin 248 par.1 lidhur me nenin 326 par.4 , nenit 359, 361, 365, 366, 368 dhe 370 të KPPK-së, te akuzuarit i:

G J Y K O N

1.Të akuzuarin D. Gj. :

-me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 12 muaj.

Ne dënimin me burg I llogaritet arresti shtëpiak nga dt.26.10.2017, deri me dt.28.12.2017.

Dënimi me burg fare nuk ka për tu ekzekutua me kushtë që i akuzuari në afat prej një viti nuk do të kryen vepër të re penale.

-me dënim me gjobë në shumë prej treqind (300,00) € euro,

Dënimi me gjobë i akuzuari është i detyruar ta paguaj në afat prej 15 ditësh, e nëse dënimi me gjobë nuk e ekzekuton apo e refuzon ekzekutimin, i njëjti dënim i zëvendësohet me burg, duke llogaritur 20 € (njëzetë euro), për një (1) ditë burgu.

-dënimi plotësues:

-i konfiskohen 623.8 gram narkotik të llojit marihuan , 25 qese plasmasi dhe 1 mulli për bluarje të marihuanes të cilat pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi kanë për tu asgjësua.

I akuzuari detyrohet që Gjykatës në emër të shpenzimeve të procedurës të ja paguaj shumën prej 50 euro ndërsa në emër të paushallit gjyqësor, shumën prej 25 € si dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit shumën prej 50 euro.

2.Të akuzuarin B. A. :

-me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 12 muaj

Ne dënimin me burg I llogaritet paraburgimi nga dt.11.08.2018 deri me dt.10.09.2018.

Dënimi me burg, fare nuk ka për tu ekzekutua me kushtë që i akuzuari në afat prej një viti nuk do të kryen vepër të re penale.

-me dënim me gjobë në shumë prej treqind (300,00) € euro,

Dënimi me gjobë i akuzuari është i detyruar ta paguaj në afat prej 15 ditësh, e nëse dënimi me gjobë nuk e ekzekuton apo e refuzon ekzekutimin, i njëjti dënim i zëvendësohet me burg, duke llogaritur 20 € (njëzetë euro), për një (1) ditë burgu.

-Dënimi plotësues:

- i konfiskohen, 8.2 gram kokainë, 2.1 gram marihuan , 0.3 gram hashash, 1 peshore digjitale , të cilat pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi kanë për tu asgjësua.

-i konfiskohet shuma e të hollave prej një mijë e pesëdhjetë (1.050,00) euro. të cilat pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit kanë për tu derdhur në buxhetin e Kosovës.

I akuzuari detyrohet që Gjykatës në emër të shpenzimeve të procedurës të ja paguaj shumën prej 50 euro ndërsa në emër të paushallit gjyqësor, shumën prej 25 € si dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit shumën prej 50 euro.

3.Të akuzuarin E. A. :

-me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 12 muaj

Dënimi me burg fare nuk ka për tu ekzekutua me kushtë që i akuzuari në afat prej një viti nuk do të kryen vepër të re penale.

-me dënim me gjobë në shumë prej treqind (300,00) € euro,

Dënimin me gjobë i akuzuari është i detyruar ta paguaj në afat prej 15 ditësh, e nëse dënimi me gjobë nuk e ekzekuton apo e refuzon ekzekutimin, i njëjti dënim i zëvendësohet me burg duke llogaritur 20 € (njëzetë euro), për një (1) ditë burgu.

I akuzuari detyrohet që Gjykatës në emër të shpenzimeve të procedurës të ja paguaj shumën prej 50 euro ndërsa në emër të paushallit gjyqësor, shumën prej 25 € si dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit shumën prej 50 euro.

Të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pasi që aktgjykimi të merë formën e prere

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore – Departamenti për Krime të Renda në Pejë, me aktakuzën PP.I nr.125/17 dt.18.01.2019 të ndryshuar me dt. 18.03.2019 dhe në shqyrtimin kryesorë dt.09.10.2019, i ka akuzua të akuzuarit D.Gj. , për veprë penale, blerja posedimi shpërndarja, shitja e pa autorizuar i narkotikeve , substancave psiko-tropike dhe analoge nga neni 273 par.1 të KPK-së dhe të akuzuarit B. A e E. A , si bashkë kryes për shkak të veprës penale, blerja posedimi shpërndarja, shitja e pa autorizuar i narkotikeve , substancave psiko-tropike dhe analoge nga neni 273 par.2 lidhur me nenin 31 të KPK-së

Në shqyrtim kryesorë Prokurori i Shtetit Sahide Gashi ka mbete në tersi pranë aktakuzës, kualifikimit të njëjtë juridik të veprës penale.

I akuzuari D.Gj. që në fillim të shqyrtimit gjyqësor, në tërësi e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet.

Mbrojtësi i të akuzuarit Av. Flamur Kelmendi, ka deklarua se i pandehuri e ka pranuar fajësinë pa presion nga as kush, e pas këshillave të mjaftueshme që i ka pasur me mbrojtjen, pajtohem me pranimin e fajësisë.

I akuzuari B. A që në fillim të shqyrtimit gjyqësor, në tërësi e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet.

Mbrojtësja e të akuzuarit Av.Filloreta Hoxha , ka deklarua se i pandehuri e ka pranuar fajësinë pa presion nga as kush, e pas këshillave të mjaftueshme që i ka pasur me mbrojtjen, pajtohem me pranimin e fajësisë.

I akuzuari E. A që në fillim të shqyrtimit gjyqësor, në tërësi e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet.

Mbrojtësi i të akuzuarit Av. Rrustem Lajqi , ka deklarua se i pandehuri e ka pranuar fajësinë pa presion nga as kush, e pas këshillave të mjaftueshme që i ka pasur me mbrojtjen, pajtohem me pranimin e fajësisë.

Prokurori i Shtetit është pajtuar me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve për secilin veq e veq.

Meqenëse të akuzuarit që në fillim të shqyrtimit gjyqësor, në tërësi e kanë pranuar fajësinë për veprat penale për të cilat akuzohen, Prokurori i Shtetit, është pajtuar me pranimin e fajësisë , gjykata është bindur se të akuzuarit fajësinë e kanë pranua pa presion nga askush e pas këshillave

të mjaftueshme nga mbrojtësit, Gjykata është bindë se ata e ka kuptua natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë është i bazuar në provat në shkresa të lëndës, raporti policor dëftesa për konfiskimin e narkotikut, aktakuza nuk përmban asnjë nga shkeljet e qarta ligjore Për këtë gjykata ka gjetë se janë plotësuar kërkesat e parapara me nenin 248 par.1 të KPPK-së, ashtu që në kuptim të nenit 326 par.4 të KPPK-së e ka pranua pranimin fajësisë nga ana e të akuzuarve për të akuzuarin D. Gj., për vepër penale, blerja posedimi shpërndarja, shitja e pa autorizuar i narkotikeve , substancave psiko-tropike dhe analoge nga neni 273 par.1 të KPK-së dhe për të akuzuarit B. A dhe E. A , si bashkë kryes për vepër penale, blerja posedimi shpërndarja, shitja e pa autorizuar i narkotikeve , substancave psiko-tropike dhe analoge nga neni 273 par.2 lidhur me nenin 31 të KPK-së.

Meqë të akuzuarit e kanë pranuar fajësinë, pranimi i fajësisë është i bazuar në provat në shkratat e lëndës, me këtë gjykata vërteton se të akuzuarit ditën, kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit, i akuzuari D.Gj. ka krye vepër penale, blerja posedimi shpërndarja, shitja e pa autorizuar i narkotikeve , substancave psiko-tropike dhe analoge nga neni 273 par.1 të KPK-së, të akuzuarit B. A dhe E. A , si bashkë kryes kanë krye vepër penale, blerja posedimi shpërndarja, shitja e pa autorizuar i narkotikeve , substancave psiko-tropike dhe analoge nga neni 273 par.2 lidhur me nenin 31 të KPK-së.Për këtë gjykata të akuzuarit secilin veq e veq i ka shpallë fajtor dhe penalisht përgjegjës.

Para se të vendoset mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat rënduese dhe ato lehtësuese të cilat kishin për të ndikua në llojin dhe lartësinë e dënimit. Për të akuzuarin B. A si rrethanë rënduese është marrë fakti se ai është recidivistë i veprave penale, ndërsa që në raport me të akuzuarit tjerë gjykata nuk ka gjetë rrethana rënduese. Si rrethana lehtësuese në raport me të gjith të pandehurit, janë marrë sjellja e të akuzuarve pas kryerjes se veprës penale- bashkëpunimi me organet e ndjekjes e posaçërisht faktin se të akuzuarit që në fillim të shqyrtimit gjyqësor në tërësi e ka pranua fajësinë për veprën penale për të cilën janë akuzua.

Duke marrë parasysh këto rrethana gjykata të akuzuarit secilin veq e veq i ka gjykuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kështu është vendosur me bindje të thellë se këto dënime janë në harmoni me intensitetin e lartë të rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale të kryer dhe të shkalles së përgjegjësisë penale të të akuzuarve dhe se këto dënime do të shërbej si preventiv gjenerale e posaçërisht i asaj individuale, të forcimit të moralit të shoqërisë dhe disiplinës qytetare, e që është në pajtueshmëri me kërkesat e popullit, me bindje që edhe me këto dënime, do të arrihet edhe qëllimi i ndëshkimit i paraparë me nenin 41 par.1 pika 1 dhe 2 të KPK-së.

Vendimi që të akuzuarit të ja kompensojnë gjykatës shpenzimet në formë paushalli është i bazuar në nenin 450 par.2 pika 6 të KPRK-së, , ndërsa që vendimi që të akuzuarit të detyrohet që në emër të kompensimit të viktimave të krimit, të paguaj shumen prej nga 50 ero, është i bazuar në nenin 39, par. 3, pikat 3.1 dhe 3.2, të Ligji për kompensimin e viktimave të krimit Nr. 05/L -036 dhe është gjykua në lartësinë si në dispozitiv, me bindje se të akuzuarit i kanë kushtet për përmbarrim.

Nga sa u tha me lartë, u vendosë si në dispozitiv të këtij aktgjykimit.

U VENDOS NE GJYKATEN THEMELORE – DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA NË PEJË, me dt.-09.10.2019

DKR. P.nr.03/2019

Sekretarja Juridike
Binake Mulliqi

Kryetari i Trupit Gjykes - Gjyqtari
Sylë Lokaj

Anëtarët e trupit gjykues-Gjyqtarët

1. Sejdi Blakaj d.v.
2. Ahmet Regjaj d.v.

UDHZIM JURIDIK

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa ne afat prej 15 ditësh , pas marrjes, Gjykatës së Apelit ne Prishtinë e përmes kësaj Gjykate.